



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

12.09.2012

## KOMUNIKATË PËR MEDIA

### Terheqet nga nga Vala 56 e privatizimit

### Ndërmarrja e Re Barnatorja Pozharan

**Prishtinë-** Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) njofton se ka tërhequr nga tenderi për privatizim Ndërmarrjen e Re Barnatorja Pozharan.

Kjo ndërmarrje ishte paraparë të privatizohet me datë 19 shtator 2012 përmes Valës 56 të privatizimit, ndërsa tërheqja nga tenderët është bërë për çështje pronësore.

Lista e ndërmarrjeve që do të privatizohen përmes Valës 56 tani përmban 34 Ndërmarrje të Reja, të cilat do të privatizohen përmes metopdës Spin off i Rregullt.

Afati i fundit për parakualifikim për Valën 56 është dita e mërkurë, 12 shtator 2012. Dita për dorëzimin e ofertave është caktuar data 19 shtator 2012, nga ora 10:00 deri në orën 12:00, kurse hapja e ofertave do të bëhet po të njëjtën ditë duke filluar nga ora 12:30.

Në vazhdim mund të gjeni të bashkangjitur listën e plotë të ndërmarrjeve të parapara për shitje përmes Valës 56 të privatizimit:

**Ndërmarrja e re Toka Bujqësore Sverkë 3 Sh.p.k.** - përfshinë kompleksin e tokës bujqësore në një hapësirë prej 141 ha, 43 ari dhe 23 m<sup>2</sup> që shtrihet në disa parcela në Zonën Kadastrale Sverrkë, Komuna Pejë.

**Ndërmarrja e Re Toke Radisheve - Skenderaj Sh.p.k.** - përbëhet prej tokës bujqësore, me lokacion në fshatin Radisheve, komuna e Skenderajt, e cila përafërsisht përfshinë një sipërfaqe prej 15 ha 37 ari 32m<sup>2</sup>.

**Ndërmarrja e Re Tokë Extra - Vushtrri Sh.P.K** - përbëhet prej tokës , me lokacion në Vushtrri , e cila përfshinë një sipërfaqe prej përafërsisht 4 ha 40 ari 00m<sup>2</sup> .

**Ndërmarrja e Re IBG Shitorja Sh.P.K** - kjo ofertë do të ofrojë mundësi të shkëlqyeshme për të blerë shitoren me përafërsisht 39m<sup>2</sup>.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Lokacioni i saj, në qendër te qytetit te Gjilanit, ofron mundësi të shkëlqyer për afarizëm ekonomik.

**Ndërmarrja e Re IBG Gërmovë Sh.P.K** - Kjo ofertë do të ofrojë mundësi të shkëlqyeshme për të blerë tokën në sipërfaqe prej 1ha 52ari 37m<sup>2</sup> brenda cilës është i ndërtuar objekti njëkatësh prej 986m<sup>2</sup>. Nododhet në fshatin Gërmovë, Komuna e Vitisë. Objekti është i pajisur me infrastrukture përcjellëse dhe i përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme biznesore, gjithashtu kjo pronë ka qasje në rrugën kryesore që lidhë Vitinë me rrugën magjistrale Prishtine - Shkup.

**Ndërmarrja e Re Vreshtaria 1 - Tokë Bujqësore Novakë Sh.P.K.** - përfshin tokën bujqësore (vreshta jo aktiv) me sipërfaqen e përgjithshme prej përafërsisht 55 ha 92 ari 34 m<sup>2</sup>. Ndërmarrja e Re ofron sipërfaqe të mjaftueshme tokësore të përshtatshme për prodhimin e rrushit si dhe kultivimin e drithërave të ndryshëm në shkallë industriale. Kushtet klimatike dhe toka i mundësojnë pronarit të ardhshëm të vazhdojë me kultivimin e rrushit.

**Ndërmarrja e Re Vreshtaria 2 - Tokë Bujqësore Novakë Sh.P.K.** - përfshin tokën bujqësore (vreshta jo aktiv) me sipërfaqen e përgjithshme prej përafërsisht 129 ha 75 ari 61 m<sup>2</sup>. Ndërmarrja e Re ofron sipërfaqe të mjaftueshme tokësore të përshtatshme për prodhimin e rrushit si dhe kultivimin e drithërave të ndryshëm në shkallë industriale. Kushtet klimatike dhe toka i mundësojnë pronarit të ardhshëm të vazhdojë me kultivimin e rrushit.

**Ndërmarrja e Re Vreshtaria 3 - Tokë Bujqësore Novakë Sh.P.K.** - përfshin tokën bujqësore (vreshta jo aktiv) me sipërfaqen e përgjithshme prej përafërsisht 86 ha 03 ari 26 m<sup>2</sup>. Ndërmarrja e Re ofron sipërfaqe të mjaftueshme tokësore të përshtatshme për prodhimin e rrushit si dhe kultivimin e drithërave të ndryshëm në shkallë industriale. Kushtet klimatike dhe toka i mundësojnë pronarit të ardhshëm të vazhdojë me kultivimin e rrushit. Vërejtje: Ne mes te prones se cekur si me larte kalon traseja e Autostrades Vermice Merdare.

**Ndërmarrja e Re Vreshtaria 4 - Tokë Bujqësore Novakë Sh.P.K** - përfshin tokën bujqësore (vreshta jo aktiv) me sipërfaqen e përgjithshme prej përafërsisht 102 ha 53 ari 41 m<sup>2</sup>. Ndërmarrja e Re ofron sipërfaqe të mjaftueshme tokësore të përshtatshme për prodhimin e rrushit si dhe kultivimin e drithërave të ndryshëm në shkallë industriale. Kushtet klimatike dhe toka i mundësojnë pronarit të ardhshëm të vazhdojë me kultivimin e rrushit.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

**Ndërmarrja e Re Liria -Shitorja Rr.Adem Jashari Sh.P.K** - Shitorja për tu bartur në Ndërmarrjen e Re përfshin sipërfaqen e përgjithshme (gabariti i ndërtesës) prej përafërsisht 27.43 m<sup>2</sup>. Shitorja/ndërtesa përmban bodrumin, katin përdhes dhe katin e parë, dhe ndodhet në rrugën “Adem Jashari”, në qendër të qytetit të Prizrenit. **NJOFTIM:** ZR e AKP-së Prizren në bazë të Vendimit të Kuvendit Komunal-Prizren, ka bërë kërkesë në KK Prizren lidhur me bartjen administrative të pronës së lartpërmendur në emër të NSH-së si dhe azhurnimin e të dhënave kadastrale. Andaj, sipërfaqja e saktë do të përcaktohet pas kryerjes së veprimeve nga ana e KK Prizren. Aktualisht shitorja është e mbyllur.

**Ndërmarrja e Re Bankkos Prishtinë Sh.P.K** - përfshinë tokën me sipërfaqe përafërsisht 464 m<sup>2</sup>, dhe një ndërtesë pesë kate me bodrum e cila gjendet në Rr. Nëna Tereza, në qendër të Prishtinës përball Hotel “Grand”, me sipërfaqe totale prej përafërsisht 2,425.78m<sup>2</sup>. Ndër. Re, nuk përfshinë pasuri të tjera të NSH-së por vetëm asetet e përshkruara në këtë dokument.

**Ndërmarrja e Re Bankkos Pejë Sh.P.K.** - përbëhet nga ndërtesa 5 katëshe, një pjesë e katit përdhese dhe atij nëntokësor dhe aneks objekti i bashkëngjitur në sipërfaqe të përgjithshme prej 2400 m<sup>2</sup> si dhe sipërfaqen e tokës rreth 2262 m<sup>2</sup> në të cilën ndodhet objektet. Ndërmarrja e Re ndodhet në qendër të qytetit të Pejës dhe përbën një mundësi të shkëlqyer investimi strategjik në industrinë bankiere, të përdoret si hapsira zyre dhe/apo për shërbime tjera.

**Ndërmarrja e Re Bankkos Ferizaj Sh.P.K.** - përfshinë vetëm ndërtesën katër katëshe + përdhese dhe bodrumin, e cila e cila në bazë të skicës, përfshinë sipërfaqen totale prej përafërsisht 1655 m<sup>2</sup>. Sipërfaqja mund të ndryshoj pas matjeve në teren. Ndërtesa gjendet në Rr. Dëshmorët e Kombit pa nr. në qendër të Ferizajt.

**Ndërmarrja e Re Bankkos Kaçanik Sh.P.K.** - përfshinë lokalit afarist me një sipërfaqe totale prej përafërsisht 279 m<sup>2</sup>, nga të cilat, në përdhese 170 m<sup>2</sup> dhe në katin e parë 109 m<sup>2</sup> i cili gjendet në ndërtesën 8 katëshe në Rr. “Emin Duraku”, në qendër të Kaçanikut. Ndër.Re nuk përfshinë pasuri të tjera të NSH-së por vetëm asetet e përshkruara në këtë dokument.

**Ndërmarrja e Re Barnatorja Nr. 1 Sh.P.K.** - përfshinë lokalit afarist që gjendet në katin përdhes dhe bodrum të një ndërtese pesëkatëshe në rrugën e UQK-ës, Prishtinë, me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 750 m<sup>2</sup> (përdhes 375 m<sup>2</sup> dhe bodrum 375 m<sup>2</sup>). Sipërfaqja mund të ndryshojë pas matjeve në teren.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

**Ndërmarrja e Re Barnatorja Nr. 4 Sh.P.K.** - përfshinë lokalit afarist që gjendet në katin e parë të një ndërtese shumëkatëshe në rrugën Nënë Tereza, Prishtinë, përballë Radio Kosovës, me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 63m<sup>2</sup> sipas matjeve në terren.

**Ndërmarrja e Re Barnatorja Nr. 5 Sh.P.K.** - përfshinë lokalit afarist që gjendet në katin e parë dhe në katin e dytë të një ndërtese në rrugën Ilir Konushevi, Prishtinë, me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 427 m<sup>2</sup>.

**Ndërmarrja e Re Barnatorja Nr. 6 Sh.P.K.** - përfshinë lokalit afarist që gjendet në Objektin e Shtëpisë së Shëndetit "Dardania" në Prishtinë, me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 98 m<sup>2</sup> sipas matjeve në terren.

**Ndërmarrja e Re Barnatorja Nr. 7 Sh.P.K.** - përfshinë lokalit afarist që gjendet në Objektin e Shtëpisë së Shëndetit në "Bregun e Diellit" në Prishtinë me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 112 m<sup>2</sup> sipas matjeve në terren.

**Ndërmarrja e Re Barnatorja Fushë Kosovë Sh.P.K.** - i ofron investitorit potencial një mundësi të fitoj lokalit afarist me sipërfaqe përafërsisht 111.20 m<sup>2</sup>, e cila gjendet në qendër të Fushë Kosovës, që ofron mundësi të mira për aktivitete komerciale.

**Ndërmarrja e Re Barnatorja Podujevë Sh.P.K.** - përfshinë vetëm lokalit afarist, i cili në bazë të dokumentit pronësor përfshin sipërfaqen prej 144.74 m<sup>2</sup>, kurse sipas matjeve në terren përfshinë sipërfaqen e përgjithshme prej përafërsisht 134 m<sup>2</sup>. Lokalit afarist i lartcekur gjendet në katin e parë në kuadër të objektit banesor në Rr. Zahir Pajaziti në Podujevë.

**Ndërmarrja e Re Rilindja Libraria Pejë Sh.P.K.** - i ofron investitorit potencial një mundësi të fitoj lokalit afarist me sipërfaqe përafërsisht 24 m<sup>2</sup>, e cila gjendet në qendër të Pejës, që ofron mundësi të mira për aktivitete komerciale.

**Ndërmarrja e Re Shitorja e ngastra në Gojbulë dhe ngastra në Gracë Sh.P.K.** - përbehet nga një shitore dhe tokë në Fshatin Gojbulë dhe tokë në Fshatin Gracë Komuna e Vushtrrisë.

- Shitorja (me ish emrin Avalla 3219) që pritet të bartet të Ndër. e Re gjendet në qendër të Fshatit Gojbulë përball shkollës fillore të fshatit; Komuna e Vushtrrisë dhe përfshin ndërtesën dhe tokën me sipërfaqe përrreth 199m<sup>2</sup>.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

- Ngastra komerciale (me ish emrin "29 Nëntori" 1348/74) që pritet të bartet te Ndër. e Re gjendet në qendër të fshatit Gracë dhe përfshin vetëm tokën një sipërfaqe përrreth 1748 m<sup>2</sup>.

**Ndërmarrja e Re Univerzal Depo Sh.P.K.** - Ka gjithsejt 7,497 m<sup>2</sup> nga toka pjese e Ndermarrjes se Re. Ka rreth 2,655 m<sup>2</sup> hapësirë të ndërtuar dhe te ndarë midis një depoje kryesore prej rreth 2,465 m<sup>2</sup>, një ndërtesë administrative prej rreth 182m<sup>2</sup> dhe një portë të sigurisë prej përafërsisht 8m<sup>2</sup>. Magazina është e ndarë në 4 sipërfaqe të barabarta e të pavarura magazinimi. Prona gjendet në Slaniste, Komuna e Leposaviqit.

**Ndërmarrja e Re Jugobanka Zyra në Skenderaj Sh.P.K.** - Kjo shitje i mundëson blerësve potencial të blejnë hapësirat për zyre në një sipërfaqe prej 80 m<sup>2</sup>, që gjenden në katin përdhes të objektit të banimit në qendër të Skenderajt, afër sheshit Adem Jashari, pranë barnatores së qytetit. Nuk ka tokë për të transferuar në Ndër. të re. **Vërejtje:** Prona është e uzurpuar nga shfrytëzuesit ilegal.

**Ndërmarrja e Re Jugobanka Zyra ne Zvecan Sh.P.K.** - Kjo shitje i mundëson blerësve potencial të blejnë hapësirat për zyre në një sipërfaqe prej 78.49 m<sup>2</sup>, që gjenden në katin përdhes të objektit të banimit në qendër të Zveçanit, në rrugën Mbreti Milutin p.n. Nuk ka tokë për të transferuar në Ndër. të re. **Vërejtje:** Prona është e uzurpuar nga shfrytëzuesit ilegal.

**Ndërmarrja e Re Jugobanka Zyra në Zubin Potok Sh.P.K.** - Kjo shitje i mundëson blerësve potencial të blejnë hapësirat për zyre në një sipërfaqe prej 90m<sup>2</sup>, që gjenden në katin përdhes të objektit të banimit në qendër të Zubin Potok, në rrugën Kolasinksih Knezeva p.n. Nuk ka tokë për të transferuar në Ndër. të re. **Vërejtje:** Prona është e uzurpuar nga shfrytëzuesit ilegal.

**Ndërmarrja e Re Gllavotin Sh.P.K.** - përbehet prej tokës bujqësore, me lokacion në fshatin Gllavotin e regjistruar ne Certifikaten mbi te drejtat e prones se paluajtshme me nr .UL-70202017-00064, komuna e Vushtrrisë, përafërsisht përfshinë 10 ha 04 ari 92 m<sup>2</sup>.

**Ndërmarrja e Re Rilindja Zona Industriale Sh.P.K.** - i ofron blerësve potencial mundësi për blerjen e tokës me një sipërfaqe prej përafërsisht 1 ha 23 ari 31 m<sup>2</sup> dhe dy ndërtesa komerciale me sipërfaqe totale prej përafërsisht 2,105 m<sup>2</sup>, që gjendet në Zonën Industriale të Prishtinës.

**Ndërmarrja e Re Tokë Bujqësore Gjylekarë SH.P.K.** - Prona kryesore e kësaj Ndërmarrjeje të Re përbëhet nga toka bujqësore që gjendet në



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

afërsi të fshatit Gjylekar, Komuna e Vitisë. Prona e përgjithshme që do t'i bartet Ndërmarrjes së Re ka një sipërfaqe të përafërt prej 37.8 ha.

**Ndërmarrja e Re KBK Strezoci objekti administrativ dhe oborri**

**Sh.P.K.** - Kjo ofertë do të sigurojë një mundësi të shkëlqyer për të blerë ngastër toke në madhësi prej përafërsisht 2250 m<sup>2</sup>, së bashku me ndërtesën me rreth 160 m<sup>2</sup> të përshtatshme si pikë për grumbullimin e produkteve të ndryshme bujqësore (qumështi, kërpudhat, etj) dhe vend për shitjen e sendeve të ndryshme bujqësore, të vendosura në fshatin Strezovcë 12 km nga qyteti i Kamenicës.

**Ndërmarrja e Re Tokë Bujqësore Rastavicë D Sh.P.K.** - përbëhet kryesisht nga toka bujqësore prej 07 ha 01 ari and 22 m<sup>2</sup> dhe gjendet në Fshatin Rastavicë, Komuna e Deçanit në distancë më pak se një km nga rruga rajonale Gjakovë - Deçan. Ky tender i ofron investitorit potencial mundësinë e zhvillimit të mëtejme të agrobiznesit në rajonin e Deçanit

**Ndërmarrja e Re Dukagjiniremont – Depo Sh.P.K.** - përfshin depon me sipërfaqe 406 m<sup>2</sup> e cila ndodhet në katin përdhësë të një objekti banesor afër Stacionit të Autobusëve, Komuna Pejë.

**Ndërmarrja e Re Vreshtaria 1 - Toka Bujqësore Smaq Sh.P.K.** - përfshin tokën bujqësore (vreshta jo aktiv) me sipërfaqen e përgjithshme prej përafërsisht 18 ha 35 ari 20 m<sup>2</sup>. Ndërmarrja e Re ofron sipërfaqe të mjaftueshme tokësore të përshtatshme për prodhimin e rrushit si dhe kultivimin e drithërave të ndryshëm në shkallë industriale. Kushtet klimatike dhe toka i mundësojnë pronarit të ardhshëm të vazhdojë me kultivimin e rrushit.

**FUND**